Hidrokarburët aromatikë policiklikë ^{d, e}	% (m/m)	-	8,0	EN 12916
Përmbajtja e squfurit ^f	mg/kg	-	350 (deri 31-12- 2004) ose 50,0	EN ISO 20846 EN ISO 20847 EN ISO 20884
			10,0	EN ISO 20846 EN ISO 20884
Pika e flakërimit	°C	mbi 55	-	EN ISO 2719
Përmbajtja e koksit ^g (në 10 % mbetje distilimi)	% (m/m)	-	0,30	EN ISO 10370
Përmbajtja e hirit	% (m/m)	-	0,01	EN ISO 6245
Përmbajtja e ujit	mg/kg	-	200	EN ISO 12937
Ndotja e përgjithshme	mg/kg	-	24	EN 12662
Korrozioni i shufrës së bakrit (3 orë në 50 °C)	vlerësim	klasa 1		EN ISO 2160
Stabiliteti ndaj oksidimit	g/m ³	-	25	EN ISO 12205
Vetitë lubrifikuese, diametri i korrektuar i njollës së gripuar (gërryer) (wsd 1,4) në 60 °C	µm	-	460	EN ISO 12156-1
Viskoziteti në 40 °C	mm ² /s	2,00	4,50	EN ISO 3104
Distilimi ^{h, i} distilati që vlon ÷ në 250°C,%(v/v) distilati që vlon ÷ në 350 °C,%(v/v) distilati që vlon në 95 % (v/v)	% (V/V) % (V/V) °C	85	< 65 360	EN ISO 3405

Treguesi cilësor	Njësia e matjes	Normat e lejuara		^a (Shiko paragrafin 2 Rekomandimet e detyrueshme)
		minimale	maksimale	
Numri i oktanit kwrkimor, RON*		51,0	-	EN ISO 5165
Numri oktanit motorrik, MON*		46,0	-	EN ISO 4264

Densiteti në 15 °C ^c	kg/m ³	820	845	EN ISO 3675 EN ISO 12185
Hidrokarburët aromatikë policiklikë ^{d, e}	% (m/m)	-	8,0	EN 12916
Përmbajtja e squfurit ^f	mg/kg		10,0	EN ISO 20846 EN ISO 20884
Korrozioni i shufrës së bakrit (3 orë në 50 °C)	vlerësi m	klasa 1	EN ISO 2160	Korrozioni i shufrës së bakrit (3 orë në 50 °C)
Pamja e jashtme*		Epastër dhe e tejdukshme		Vizuale
Distilimi				EN ISO 10370
Përmbajtja e hirit	% (m/m)	-	0,01	EN ISO 6245
Përmbajtja e ujit	mg/kg	-	200	EN ISO 12937
Ndotja e përgjithshme	mg/kg	-	24	EN 12662
Korrozioni i shufrës së bakrit (3 orë në 50 °C)	vlerësi m	klasa 1		EN ISO 2160
Stabiliteti ndaj oksidimit	g/m ³	-	25	EN ISO 12205
Vetitë lubrifikuese, diametri i korrigtuar i njollës së gripuar (gërryer) (wsd 1,4) në 60 °C	µm	-	460	EN ISO 12156-1
Viskoziteti në 40 °C	mm ² /s	2,00	4,50	EN ISO 3104
Distilimi ^{h, i} distilati që vlon ÷ në 250°C,%(v/v) distilati që vlon ÷ në 350 °C,%(v/v) distilati që vlon në 95 % (v/v)	% (V/V) % (V/V) °C	85	< 65 360	EN ISO 3405

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Lejen e Tregtimit të Karburanteve në përputhje me Ligjin Nr.8450, datë 24.02.1999 (me ndryshimet përkatëse) “Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të shoqëruar me Autorizimin për Lejen e Tregtimit të Karburanteve, në zbatim të Ligjit Nr. 8450 datë 24.02.1999 (me ndryshimet përkatëse) “Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”.

- **Operatori Ekonomik duhet të paraqesë fletë - analizë lëshuar nga organi kompetent që vërteton cilësinë e produktit objekt i kësaj kontrate që Operatori Ekonomik tregëton, sipas standarteve të përcaktuara në pajtueshmëri me specifikimet teknike të marrë jo më parë se muaji Gusht 2021, si dhe certifikatën e origjinës dhe cilësisë së mallit (Fletë-analizë për karburant gazoil 10 ppm).**
- **Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës që garanton furnizimin e pandërprerë sipas vendndodhjes së kërkuar si më poshtë.**

Operatori Ekonomik duhet të sigurojë dhe garantojë furnizimin me karburant sipas standardeve shtetërore në fuqi **S SH EN 590:2017 (Diesel) ose ekuivalente me të, e njohur nga Standartet Shqipëtare**, me lëng, karta elektronike ose tollona (bileta) të vlefshëm në pika shitje karburanti (me shërbim 24 orë, çdo ditë të javës) të vendosur në Njësinë Administrative Burrel/ Bashkia Mat.

- **Afatet e lëvrimit: Malli do të ofrohet për gjatë gjithë periudhës me karta elektronike, tollona (bileta), sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë furnizim sa herë ta ketë të nevojshme. Kërkesa do jetë në formën e kërkesës zyrtare me shkrim ose në mënyrë elektronike (e-mail).**

Sasia e karburantit do të jetë e disponueshme për t'u tërhequr nëpërmjet tollonave ose e kredituar në kartat elektronike në pikën e karburantit të shoqërisë. Furnizimi të kryhet sipas nevojave, në llogarinë elektronike të AK ose me tollona bileta me prerje 10 dhe 20 litra. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë një aplikacion elektronik për kreditimin në kohë reale të sasisë së karburantit me mënyrën elektronike për çdo mjet të AK. Kartat elektronike të furnizimit duhet të ofrohen nga Operatori Ekonomik për Autoritetin Kontraktor pa kosto shtesë sa herë që të jetë e nevojshme. Kërkesat për pajisje me kartë elektronike furnizimi do të bëhen nga përfaqësuesi i AK me shkresë zyrtare ose e-mail.

Në qoftë se ndryshon forma e tollonit biletë, ato që janë në përdorim duhet të zëvendësohen.

Tollonat biletë të jenë me firmën, vulën e furnizuesit, dhe të njëjtën logo me pikën e karburantit, të jenë të pajisur me *Element Sigurie*, të jenë të vlefshëm për t'u përdorur gjatë gjithë vitit 2021 dhe 2022, dhe të mund të përdoren në pikën e karburantit të furnizuesit.

Tollonat biletë nuk duhet të jenë të skadueshëm apo me afat.

Furnizimi i mjeteve të AK. do të bëhet çdo ditë 24h/24h .

E drejta për të kërkuar fillimin e lëvrimit të karburantit do të jetë menjëherë nga momenti i nënshkrimit së kontratës, por gjithmonë sipas nevojave dhe kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Malli do të ofrohet, me tollona biletë ose duke kredituar llogarinë elektronike të AK sipas nevojave OE duhet të furnizojë me karburant AK, lëvrimi i mallit do kryhet periodikisht me tollona biletë ose duke kredituar llogarinë elektronike.

Me paraqitjen e kërkesës nga AK kontraktuesi është i detyruar të furnizojë autoritetin kontraktor në sasinë korresponduese të tollonave ose të sasisë elektronike duke përfshirë në çmimin e tyre gjithë detyrimet fiskale që ka shteti shqiptar.

Kohëzgjatja e kontratës: nga momenti i nënshkrimit deri më datë 31.12.2021

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet: 42 967.8 *(dyzet e dy mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë tetë) litra.*

Afatet e lëvrimit: Nga momenti i nënshkrimit të kontratës deri më datë 31.12.2021

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periodha e dorëzimit

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 7).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2018, 2019, dhe 2020**, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit të kontratës që prokurohet.
- 2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2018, 2019, dhe 2020**, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur

janë në kushtet e përcaktimeve të *ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009*, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

- 2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2020** dhe **2021** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku nëse shpallet fitues, përpara nënshkrimit të kontratës duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së.

2.3 Kapaciteti teknik:

- 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limitit që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- 2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me liçencë për stacionin e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë sipas ligjit Nr. 8450, datë 24.02.1999 dhe VKM-së Nr.970, datë 02.12.2015 *“Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënie të liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”* (i ndryshuar).

- 2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Autorizim *“Për Hyrje Dalje në rrugë”* për pikën e tregtimit me pakicë të stacionit të shitjes, ku për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqesë Autorizimin e lëshuar nga Bashkia (e vlefshme).

- 2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të disponojë 1 (një) pikë furnizimi me vendodhje në Njësine Administrative Burrel/ Bashkia Mat, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontrate noteriale ose akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e QKB-së, etj). Ky stacion furnizimi të jetë i pajisur me leje mjedisore të tipit C, Vërtetim Teknik nga ISHTI ose nga një shoqëri e akredituar, Akt-Teknik nga PMNZH, dhe Policë sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për shitjen me pakicë.

-
- 2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit Shqiptar, dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë për vitin 2020.
- 2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë fotokopje të deklaratave doganore të produktit të furnizuar gjatë 6 muajve të fundit nga data hapjes së ofertave, për të vërtetuar që është importues/ ose kontratues me një shoqëri importuese për furnizimin e produktit që prokurohet.
- 2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Vërtetim Teknik të lëshuar nga ISHTI ose nga një shoqëri e akredituar, Leje Mjedisore të tipit C, të lëshuar nga QKL, Akt-Teknik të lëshuar nga PMNZH, dhe Policë Sigurimi lëshuar nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për depozitat e tregtimit që vërteton kapacitetet depozituese jo më pak se 40 m³ lidhur me rezervat e operatorit ekonomik, për të garantuar vazhdimësi në furnizim, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
- 2.3.8 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë fletë-analizën e kontrollit të kryer në stacionin e tij, dhe/ose të furnizuesit të produktit, për produktin **Diesel 10 PPM S SH EN 590:2017 ose ekuivalente me të, e njohur nga Standartet Shqipëtare**, lëshuar nga organi kompetent ose nga një laborator shqiptar ose i huaj (*n.q.s është laborator i huaj duhet e përkthyer dhe e noterizuar në shqip*), që vërteton cilësinë e produktit objekt i kësaj kontrate që ofertuesi tregton, sipas standarteve të përcaktuara në pajtueshmëri me specifikimet teknike të lëshuar jo më parë se muaji Gusht 2021.
- 2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë edhe deklaratat si më poshtë:
- Operatori ekonomik duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin në stacion të shitjes së karburantit me pakicë në pistoletë publike me shërbim 24 orë në çdo ditë të javës, deri në përfundim të Kontratës dhe me vendndodhje në Njësinë Administrative Burrel/ Bashkia Mat me kartë elektronike të personalizuar me targën e çdo automjeti të autoritetit kontraktor ose tollona në formë biletash, në adresën e kërkuar dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
 - Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër që të furnizojë të gjithë sasinë e litrave të ndodhura në kartën elektronike të personalizuar me targën e mjetit, deri në përfundimin e plotë të kontratës, sipas nevojave të autoritetit kontraktor. Kartat elektronike duhet të jenë pa skadencë dhe të jenë të përdorshme dhe gjatë vitit 2022.
 - Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë se ofron një ndërfaqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike. Kjo ndërfaqe e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, dhe nga llogaria elektronike e AK në mjetet e transportit, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti kontraktor. Ndërfaqja duhet të ofrojë edhe mundësinë e afishimit të disa raporteve të cilat do të ndihmojnë AK për marrjen e vendimeve operacionale.
 - Disponimi/ Ekzistenca e ndërfaqes së menaxhimit të karburantit (webpage), së bashku me ofrimin shërbimeve të kërkuara mësipër, do të demonstrohen nga ana e operatorit ekonomik

pjesëmarrës me shembuj për zbatimin në praktikë, në prani anëtarëve të KVO-së së Autoritetit kontraktor përpara mbylljes së procesit të kualifikimit dhe shpalljes së fituesit.

Mosofrimi i Ndërfaqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), përbën kusht për skualifikim.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I.Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	_____
Numri NIPT/et:	_____
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	_____
Përfaqësuesi (emri):	_____
Telefoni:	_____
E-mail:	_____

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni]

kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.	Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:	
1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklarate;	Po []
2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;	Po []
3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të	Po []

paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;	
4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;	Po []
5. Për efekt të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që: a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor; b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës .	Po []
6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;	Po [] Jo []
7. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nën-kontraktimit).	Po [] Jo []
8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me : a) çmimet; b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit; c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur	Po [] Jo []

një ofertë ose jo; ose d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës.	
9. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose dërgesat specifike të mallrave ose shërbimeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.	Po [] Jo []
10. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht në pikën 7 më lart.	Po [] Jo []

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.
Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë: - Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit të Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil. Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet

këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005.

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th.

bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2022 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:	
1. Operatori ekonomik garanton mbrojtjen e së drejtës për punësim dhe profesion nga çdo formë e diskriminimit parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.	Po [] Jo []
2. Operatori ekonomik ka kontratat përkatëse të punës me punonjësit e tij dhe garanton masa sigurie dhe shëndetësore për të gjithë dhe, në veçanti, për grupet në nevojë, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.	Po [] Jo []

3. Operatori ekonomik nuk ka ndonjë masë efektive ligjore të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale (ISHPSHSH). Në rastet kur janë identifikuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.	Po [] Jo []

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se: Unë kam punonjës të nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: Profili i punonjësve <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:

Data e dorëzimit të deklaratës _____	Vula _____
Emri, Mbiemri, Firma _____	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, **një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit** duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë të informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

***Shenim:** Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

Shtojca 9

Formulari i Njoftimit të Skualifikimit²

[Vendndodhja dhe data]

[Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor]

[Adresa e Ofertuesit]

I nderuar, Z. / Znj. <Emri i kontaktit >

Ju falënderojmë për pjesëmarrjen tuaj në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit publik. Procedura u zhvillua në përputhje me Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes në bazë të kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informojmë se jeni skualifikuar pasi oferta e paraqitur nga ju është refuzuar për arsyen (et) e mëposhtme:

Nëse mendoni se autoriteti/enti kontraktor ka shkelur LPP-në ose RPP-në gjatë procedurës së prokurimit publik, ju keni të drejtë të inicioni një procedurë rishikimi pas publikimit të njoftimit të fituesit sipas parashikimeve të Kapitullin XIV të Ligjit të Prokurimit Publik.

Megjithëse nuk mund t'i përdorim shërbimet tuaja në këtë rast, ne besojmë se do të mbeteni të interesuar për iniciativat tona të prokurimit.

Me respekt,

Titullari i Autoritetit/Entit Kontraktor

²Ky njoftim do të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit të zhvilluara në rrugë shkresore

Shtojca 10

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data]

Drejtuar: [Emri dhe adresa e Ofertuesit fitues]

Procedura e prokurimit/lotit:

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [Objekti, sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

